



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS
KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

Nr. 135 Prot.

Tiranë, më 01/07/2024

NJOFTIM

Komisioni Institucional i Zgjedhjeve (KIZ), pranë Universitetit Bujqësor të Tiranës (UBT), ju bën me dije se procesi zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese, i zhvilluar në datë 21.06.2024, përgjatë orarit 08:00-16:00, u përmbyll me sukses.

Procesi i votimit u zhvillua në 7 Qendra votimi, të vendosura në 5 Njësi Kryesore të UBT-së.

Në garë ishin 75 kandidatë (Personel Akademik dhe Student) për 54 pozicione autoritet drejtues dhe anëtar i Senatit Akademik i UBT-së.

Në këtë proces, patën mundësinë të shprehin qëndrimin e tyre 283 anëtarë të stafit akademik dhe 6034 studentë që vijojnë studimet në UBT.

Procesi zgjedhor ka vijuar normalisht dhe pjesëmarrja e trupës zgjedhore në votime ishte në nivele shumë të kënaqshme. Kështu, pjesëmarrja në votime e personelit akademik ishte 99.6%, dhe ajo e studentëve ishte 15.5%.

Dëshirojmë të falënderojmë për bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen në votime të gjithë studentët e UBT-së dhe gjithë stafin akademik, të cilët iu drejtuan kutive të votimit.

Gjithashtu, falënderojmë Administratën e UBT-së dhe stafin administrativ, për mbështetjen e pa kursyer në drejtim të infrastrukturës zgjedhore dhe në garantimin e mbarëvajtjes së procesit zgjedhor.

Në mënyrë të veçantë, dëshirojmë t'ju urojmë suksese dhe mbarësi në detyrën e re, të gjithë Autoriteteve drejtuese në të gjitha nivelet dhe anëtarëve të Senatit Akademik të UBT-së.

Theksojmë që pjesëmarrja e lartë në votime ishte shprehje e interesit, përkushtimit dhe mbështetjes e të gjithë trupës zgjedhore për zhvillimin e universitetit në 4 vjeçarin e ardhshëm në drejtim të edukimit, kërkimit shkencor dhe transferimit të njohurive, për një të ardhme evropiane, për ndërkombëtarizimin e tij, dhe për mbështetjen dhe realizimin e Marrëveshjes "BOKU - UBT 2030", e cila synon që të jetë UBT-në një universitet lider në rajon në fushën e shkencave të jetës.

Kryetari i KIZ

Z. Albert KOPALI

